

Emri dhe adresa e plote PEGASUS SHPK
NIPT-I J62903750A
ADRESA Rruga Siri Kodra, Nr. 149 (Ish - Frigoriferi)
Tirane

Data e krijimit 22 Maj 1995
Nr. i Regjistrimit Tregetar 1200454

STATUSI JURIDIK Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar

VEPRIMTARIA
KRYESORE Import-Export, tregeti me shumice e pakice te
medikamenteve, dhe biopreparateve, laborator
baktereologjik, pajisje sherbimi mjekesore etj

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar
dhe ligjit Nr.25/2018 ,Date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

VITI 2024

PERIUDHA KONTABEL E PASQYRAVE FINACIARE	01.01.2024 - 31.12.2024
DATA E MBYLLJES SE PASQYRAVE FINANCIARE	12.03.2025
PASQYRAT JANE INDIVIDUALE	PO
Data e depozitimit	



ESTELA GUMA

Tabela e përmbajtjes

I.	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
II.	PASQYRA E PERFORMANCËS	4
III.	PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	6
IV.	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA	7
V.	SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	8-24



Pasqyra e Pozicionit Financiar
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(Të gjitha balancat janë në lekë)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR		Shënime	Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
A AKTIVET				
I Aktive Afatshkurtera				
1 Aktive monetare	1		109,788,230	193,227,494
2 Investime	2		982,561,139	784,524,704
3 Të drejta të arkëtueshme	3		708,910,756	759,054,901
4 Inventari	4		394,091,149	382,169,552
5 Shpenzime të shtyra	5		-	-
6 Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			-	-
Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)			2,195,351,274	2,118,976,651
II Aktive Afatgjata				
1 Aktive financiare			10,740,325	14,069,940
2 Aktive materiale	6		44,823,048	32,603,655
3 Aktive biologjike			-	-
4 Aktive jo materiale			-	-
5 Aktive tatimore të shtyra			-	-
6 Kapitali i nënshkruar i papaguar			-	-
Totali i Aktiveve Afatgjata(II)			55,563,373	46,673,595
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)			2,250,914,647	2,165,650,246
B DETYRIMET DHE KAPITALI				
I Detyrime Afatshkurtra				
1 Detyrimet afatshkurtra	7		575,873,022	552,088,353
2 Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			-	-
3 Të ardhura të shtyra			-	-
4 Provizionet afatshkurtra			-	-
Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)			575,873,022	552,088,353
II Detyrime Afatgjata				
1 Detyrimet afatgjata	8		1,082,303,589	1,131,007,821
2 Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			-	-
3 Të ardhura të shtyra			-	-
4 Provizionet afatshkurtra			-	-
5 Detyrime tatimore të shtyra			-	-
Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)			1,082,303,589	1,131,007,821
Totali i Detyrimeve (I+II)			1,658,176,611	1,683,096,174
III Kapitali dhe Rezervat				
1 Kapitali i Nënshkruar	9		220,000,000	220,000,000
2 Primi i lidhur me kapitalin			-	-
3 Rezerva rivlerësimi			-	-
4 Rezerva të tjera			15,688,590	15,688,590
5 Fitimet(humbja) te pashpërndara			-	-
6 Fitimi (humbja) e vitit financiar	10		357,049,446	246,865,482
Totali i Kapitalit (III)			592,738,036	482,554,072
TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)			2,250,914,647	2,165,650,246

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.




Gjy

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(Të gjitha balancat janë në lekë)

<u>Përshkrimi i Elementëve</u>	<u>Shënime</u>	<u>Viti raportues</u> <u>31.12.2024</u>	<u>Viti paraardhës</u> <u>31.12.2023</u>
1 Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	+	1,464,098,667	1,275,108,845
2 Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit	-	-	-
3 Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	+	-	-
4 Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	+	3,945,467	1,249,454
<u>Totali i të ardhurave të shfrytëzimit (shuma 1 - 4)</u>	-	<u>1,468,044,134</u>	<u>1,276,358,299</u>
5 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-(a+b)	(1,041,235,086)	(913,697,418)
a) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-	(1,038,772,908)	(910,896,959)
b) Të tjera shpenzime	-	(2,462,178)	(2,800,459)
6 Shpenzime të personelit	-(a+b)	(81,727,589)	(81,706,013)
a) Paga dhe shpërblime	-	(75,260,267)	(75,660,164)
b) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur	-	(6,467,322)	(6,045,849)
7 Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-	-
8 Shpenzime konsumi dhe amortizimi	-	(9,213,448)	(7,924,531)
9 Shpenzime të tjera shfrytëzimi	-	(63,415,539)	(58,181,109)
<u>Totali i shpenzimeve (shuma 5 - 9)</u>	-	<u>(1,195,591,662)</u>	<u>(1,061,509,071)</u>
<u>Fitimi apo humbja nga veprimtaria e shfrytëzimit</u>	18.61%	<u>272,452,472</u>	<u>214,849,228</u>
10 Të ardhura të tjera	+	108,517,092	96,299,566
a) Të ardhura nga njësitet ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (par	+	-	-
veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)			
b) Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgj	+	-	-
(paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)			
c) Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme	+	108,517,092	96,299,566
11 Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të	-	-	-
12 Shpenzime Financiare		40,231,078	(19,481,297)
a) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas		985,712	1,384,734
shpenzimet për t'u paguar tek njësitet ekonomike brenda grupit)			
b) Shpenzime të tjera financiare		39,245,366	(20,866,031)
13 Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-	-
14 <u>Fitim/Humbja para tatimit</u>	0.00%	<u>421,200,642</u>	<u>291,667,497</u>
15 Shpenzimet e jashtëzakonshme apo jo të veprimitarisë		(6,474,001)	(7,012,604)
16 Shpenzimet i tatimit mbi fitimin	11	(64,151,196)	(44,802,015)
a) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(64,151,196)	(44,802,015)
b) Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë			
c) Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve			
17 <u>Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)</u>	10	<u>357,049,446</u>	<u>246,865,482</u>
18 <u>Fitimi/Humbja për:</u>			
Pronarët e njësive ekonomike mëmë		-	-
Interesat jo-kontrolluese		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Handwritten signature

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(Të gjitha balancat janë në lekë)

<u>Përshkrimi i Elementëve</u>	<u>Shënime</u>	<u>Viti raportues</u> <u>31.12.2024</u>	<u>Viti paraardhës</u> <u>31.12.2023</u>
1 Fitimi/Humbja e vitit		357,049,446	246,865,482
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		-	-
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shilje		-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		-	-
2 Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
3 Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		357,049,446	246,865,482
4 Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:		-	-
Pronarët e njësive ekonomike mëmë		-	-
Interesat jo-kontrolluese		-	-



Gy

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (metoda indirekte)
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda Indirekte		Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
1 Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit			
Fitim / Humbja e vitit		357,049,446	246,865,482
>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		-	-
>Shpenzimet financiare jomonetare		-	-
>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		-	-
>Shpenzime konsumi dhe amortizimi		9,213,448	7,924,531
>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:			
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		-	-
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(147,892,290)	(37,725,259)
Rënie/(ritje) në inventarë		(11,921,597)	(53,475,033)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme e në detyrime për punonjësit		(24,919,563)	192,459,158
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		181,529,444	356,048,879
2 Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		-	-
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		-	-
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(21,432,841)	(2,846,518)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		-	-
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		-	-
Dividentë të arkëtuara		-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(21,432,841)	(2,846,518)
3 Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		-	-
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		-	-
Hua të arkëtuara		3,329,615	46,375,060
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		-	-
Riblerje e aksioneve të veta		-	-
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		-	-
Pagesa e huave		-	-
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
Interes i paguar		-	-
Dividendë të paguar		(246,865,482)	(435,571,067)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(243,535,867)	(389,196,007)
Rritje/(rënie) neto në MM dhe ekuivalentë MM		(83,439,264)	(35,993,646)
Mjete monetare dhe ekuivalentë më 1 janar		193,227,494	229,221,140
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë më 31 dhjetor		109,788,230	193,227,494

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Llogore, Saturore e të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbje e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
► Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2022	220,000,000	-	-	15,688,590	-	435,571,067	671,259,657	-	671,259,657
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël	-	-	-	-	-	-	-	-	-
► Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2023	220,000,000	-	-	15,688,590	-	435,571,067	671,259,657	-	671,259,657
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fitim / Humbje e vitit	-	-	-	-	-	246,865,482	246,865,482	-	246,865,482
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Dividende të paguar	-	-	-	-	-	(435,571,067)	(435,571,067)	-	(435,571,067)
Percaktime të tjera për rezultatin e periudhës (veprime me fitimin e vitit paraardhës)	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	-	-	-	-	-	-
► Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 Dhjetor 2023	220,000,000	-	-	15,688,590	-	246,865,482	482,554,072	-	482,554,072
► Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2024	220,000,000	-	-	15,688,590	-	246,865,482	482,554,072	-	482,554,072
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fitim / Humbje e vitit	-	-	-	-	-	357,049,446	357,049,446	-	357,049,446
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Dividende të paguar	-	-	-	-	-	(246,865,482)	(246,865,482)	-	(246,865,482)
Percaktime të tjera për rezultatin e periudhës (veprime me fitimin e vitit paraardhës)	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	-	-	-	-	-	-
► Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2024	220,000,000	-	-	15,688,590	-	357,049,446	592,738,036	-	592,738,036

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(Të gjitha balancat janë në lekë).

A. Informacione të përgjithshme

PEGASUS. sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe gjendet e regjistruar në regjistrin tregtar (QKB), indentifikuar me NIPT-in J62903750A . Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Adresa e selisë së shoqërisë është Rruga Siri Kodra, tek ish frigoriferi, Nr. 149, Tiranë.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë për ushtrimin 2024 ka qenë Tregti import-export të produkteve farmaceutike, tregtim makineri dhe pajisje hospitalore etj.

Administratori i shoqërisë është z. Janis Karathano me afat emërimi deri më 16.05.2026. Kapitali i regjistruar aktualisht është 220,000,000 ALL dhe zotërohet nga ortakutë i vetëm, z. Janis Karathano me pjesëmarrje 100%. Me 31 Dhjetor 2024 shoqëria kishte 26 të punësuar. Pasqyrat financiare të Shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 janë miratuar nga Administratori i Shoqërisë.

B. Deklaratë e pajtueshmërisë me SKK-të

Pasqyrat financiare (individuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të), të përmirësuara, dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

C. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të konstatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("ALL").

D. Politikat e Parimit kontabël më domethënëse të pëdorura nga shoqëria, janë si më poshtë:

Parimi i vijimesisë

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në përputhje me parimin e vijimesisë, i cili supozon se shoqëria do të vazhdojë të operojë për një periudhë të parashikueshme në të ardhmen. Drejtimi i shoqërisë beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit të shoqërisë në kushtet aktuale. Shoqëria nuk pret që të ketë devijime nga shifrat e buxhetuara për shkak të situatës pandemike, e cila megjithatë nuk është e mundur të matet në mënyrë të besueshme dhe plotësisht në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare. Megjithatë, drejtimi i Shoqërisë beson në vijimesinë e rezultateve pozitive. Drejtimi i Shoqërisë ka bërë një vlerësim të aftësisë së Shoqërisë për të



vazhduar ne vijimesi, duke marre ne konsiderate te gjithë faktoret e permendur me lart dhe eshte besimplote se Shoqeria zoteron burime financiare te mjaftueshme per te vazhduar veprimtarine e saj per nje te ardhme te parashikueshme. Per me teper, drejtimi nuk eshte ne dijeni te ndonje pasigurie materiale qe mund te hedhe dyshime mbi aftesine e Shoqerise per te vazhduar ne vijimesi. Si rrjedhoje, Pasqyrat Financiare vazhdojne te pergatiten mbi parimin e vijimesise.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërisë dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

Aktivët dhe detyrimet financiare

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e aktivit financiar ose detyrimit financiar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave financiarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e percaktuara në pikën 7 dhe 8 të SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet



Handwritten signature in blue ink.

objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

Aktivet dhe detyrimet financiar shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në përcaktimet e SKK 2.

Të drejta të arkëtueshme

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e të drejtave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Inventarët

Fillimisht, inventari njihet atëherë kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktiv i kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit të hyrë dhe kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe e aplikon

këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëposhme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përfshihen bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e lineare, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndërtesa 5 %, për pajisjet informative 25% dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

Aktivitet afatgjatë jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri dhe aktiviteti nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërisë për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktivitet jomaterial bëhet me kosto, ndërsa vlerësimi i mëposhëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.



Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëliti) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si më poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetarë me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabel aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabel kur ato lindin.

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2024 janë:

1 Euro (EUR)	=	98.15 Leke
1 Dollar (USD)	=	94.26 Leke
1 Paund B.(GBP)	=	118.16 Leke
1 Frangë Z.(CHF)	=	104.27 Leke

Tatimin mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt në kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të përdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2024 është 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

Detyrimet Afatshkurtra e Afatgjata

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shenimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtezuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shenimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtezuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin. Një detyrim njihet në datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

Transaksionet me palet e lidhura

Palet e lidhura përbehen nga aksionarë dhe drejtoret e shoqërisë. së bashku me entitete që ata kontrollojnë. të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo pale të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.



E. Menaxhimi i rrezikut financiar

Faktoret e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqerise e ekspozojne ate ndaj nje shumellojshmerie rreziqesh financiare. qe perfshijne rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit ne kursin e kembimit te monedhave te huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut te shoqerise fokusohet ne paparashikueshmerine e tregjeve dhe synon te minimizojte efektet potenciale te kunderta mbi performancen e biznesit te shoqerise. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar ne politika te aprovuara dhe procedura qe mbulojne gjithë menaxhimin e rrezikut. si dhe çeshtje specifike, si rreziku i kursit te kembimit, rreziku i normes se interesit, rreziku i kreditit, dhe investimi i likuiditetit te tepert.

Rreziku i tregut

Rreziku i kursit te kembimit

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te kursit te kembimit qe vjen si rezultat i ekspozimit ne monedha te ndryshme kryesisht ne lidhje me Euro-n. Shoqeria nuk perdor ndonje instrument per tu mbrojtur ndaj rrezikut te kursit te kembimit. Drejtimi i shoqerise eshte pergjegjes per te mbajtur pozicione neto te pershtatshme ne çdo monedhe dhe ne total dhe te monitorojte operacionet e perditshme.

Ekspozimi i Shoqerise ndaj rrezikut te monedhes me 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqitet si vijon:

31 Dhjetor 2024	<u>Vlera kontabel</u> <u>Total</u>	<u>Ekuivalent EUR</u>	<u>Ekuivalent USD</u>	<u>Ekuivalent GBP</u>	<u>Ekuivalent CHF</u>	<u>Leke</u>
Llogari te arketueshme tregtare	705,850,087	421,366,284	5,375,725	378,112	-	278,729,966
Aktive te tjera	3,060,669	-	-	-	-	3,060,669
Depozita me afat	982,561,139	728,325,502	12,262,329	-	-	241,973,308
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	109,788,230	36,603,289	2,898,728	136,535	206,623	69,943,055
Huadhenie	10,740,325	7,410,325	-	-	-	3,330,000
Llogari te pagueshme tregtare	(554,315,951)	(543,374,446)	(1,242,601)	-	-	(9,698,904)
Detyrime te tjera	(1,082,303,589)	709,788,975	-	-	-	(1,792,092,564)
Ekspozimi neto	175,380,910	1,360,119,929	19,294,181	514,647	206,623	(1,204,754,470)

31 Dhjetor 2023	<u>Vlera kontabel</u> <u>Total</u>	<u>Ekuivalent EUR</u>	<u>Ekuivalent USD</u>	<u>Ekuivalent GBP</u>	<u>Ekuivalent CHF</u>	<u>Leke</u>
Llogari te arketueshme tregtare	722,770,704	510,758,457	2,334,363	382,304	-	209,295,580
Aktive te tjera	36,284,197	-	-	-	-	36,284,197
Depozita me afat	784,524,704	526,974,695	18,286,571	-	-	239,263,438
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	193,227,494	81,395,602	5,956,044	75,067	18,427	105,782,354
Huadhenie	14,069,940	10,439,940	-	-	-	3,630,000
Llogari te pagueshme tregtare	(545,099,445)	(544,222,060)	-	(255,328)	-	(622,057)
Detyrime te tjera	(1,131,007,821)	445,468,500	-	-	-	(1,576,476,321)
Ekspozimi neto	74,769,773	1,030,815,134	26,576,978	202,043	18,427	(982,842,809)

Flukset monetare dhe rreziku i vleres se drejte te normes se interesit

Shoqeria nuk eshte e ekspozuar ndaj ndikimeve qe luhatjet ne nivelet e normes se interesit qe mbizoterojne ne treg kane ne bilancin kontabel dhe flukset e saj te parase. Shoqeria nuk ka hua apo kredi bankare apo

Handwritten signature

financiare. Nuk ka përqendrim të fondeve të marra hua me interes nga institucionet financiare ose entitete me norme interesi variabel në datën e raportimit. Luhatjet e normës së interesit të tregut nuk kanë efekt në performancën financiare të shoqërisë.

Në të njëjtën kohë shoqëria ka vendosur aktive të shumta në depozita me afat duke përfituar të ardhura interesi shtesë, por drejtimi vlerëson që luhatja e normave të interesit të depozitave nuk ndikon performancën e shoqërisë pasi depozitat dhe të ardhurat nga interesi nuk janë të lidhura me transaksione shlyerje.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të vihet në vështirësi për të përmbushur detyrimet kontraktuale që lidhen me detyrimet financiare që shlyhen në para ose nëpërmjet një aktivi tjetër financiar. Qasja e Shoqërisë ndaj administrimit të likuiditetit është e tillë që të sigurojë, sa të jete e mundur që do të ketë mjaftueshëm likuiditet për të shlyer detyrimet e saj kur të maturohen, në kushte normale dhe nën shtypje nga faktorët e tregut, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose të rreziqeve reputacionin e Shoqërisë. Me poshtë janë maturitetet e mbetura kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare. Shumat janë bruto dhe të paskontuara, dhe përfaqësojnë edo pagesë kontraktuale interesi deri më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

31 Dhjetor 2024	Vlera Kontabel	Me pak se 6 muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit
Llogari të arketueshme tregtare	705,850,087	407,978,376	295,432,617	2,439,093
Depozita me afat	982,561,139	-	198,036,435	784,524,704
Huadhenie	10,740,325	-	-	10,740,325
TOTALI	1,699,151,551	407,978,376	493,469,052	797,704,122
31 Dhjetor 2023	Vlera Kontabel	Me pak se 6 muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit
Llogari të arketueshme tregtare	722,770,704	417,792,334	302,539,277	2,439,093
Depozita me afat	784,524,704	-	-	784,524,704
Huadhenie	14,069,940	-	-	14,069,940
TOTALI	1,521,365,348	417,792,334	302,539,277	801,033,737
31 Dhjetor 2024	Vlera Kontabel	Me pak se 6 muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit
Llogari të pagueshme tregtare	(554,315,951)	(249,442,178)	(188,467,423)	(116,406,350)
Detyrime qiraje	-	-	-	-
Detyrime të tjera	(1,082,303,589)	-	-	(1,082,303,589)
TOTALI	(1,636,619,540)	(249,442,178)	(188,467,423)	(1,198,709,939)
31 Dhjetor 2023	Vlera Kontabel	Me pak se 6 muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit
Llogari të pagueshme tregtare	(545,099,445)	(245,294,750)	(185,333,811)	(114,470,883)
Detyrime qiraje	-	-	-	-
Detyrime të tjera	(1,131,007,821)	-	-	(1,131,007,821)
TOTALI	(1,676,107,266)	(245,294,750)	(185,333,811)	(1,245,478,704)

F. Gjykime dhe vlerësime të rendesishme kontabel

Në aplikimin e politikave kontabel të shoqërisë, që përshkruhen në Shenimin 3 të ketyre pasqyrave financiare, drejtimi i kërkojë që të bëjë gjykime, çmuarje, dhe supozime për vlerën kontabel të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burime të tyre. Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me të janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktore të tjera që konsiderohen të rendesishme. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga keto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me të rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet në çmuarjet kontabel do të njihen në periudhën në të cilën çmuarja është rishikuar në qoftë se rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhat e ardhshme në qoftë se rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhme.

Pasiguria në gjykimet Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen me shumën me të cilën vlera kontabel e aktiveve ose e njësive gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset e parase nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parase.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar në datën e pasqyres së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmerinë e pritur të këtyre aktiveve. Vlera e mbetur e këtyre aktiveve është analizuar në Shenimin Nr. 6. Megjithatë, rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.

Inventari është paraqitur me vlerën me të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Gjate përcaktimit të vlerës neto të realizueshme, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive/ të dhënat e disponueshme për kryerjen e vlerësimeve.



1. Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjeteve monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 jane si me poshte:

1 Aktive monetare

- (i) Arka
- (ii) Banka
- Totali 1**

Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
45,352	111,526
109,742,878	193,115,968
109,788,230	193,227,494

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepriat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.

2. Investime

Investimet, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2024 deklarohen si vijon:

2 Investime

- (i) Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit
- (ii) Aksionet e veta
- (iii) Te tjera Financiare, depozita bankare

Totali 2

Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
-	-
-	-
982,561,139	784,524,704
982,561,139	784,524,704

3. Të drejta të arkëtueshme afatshkurtra

Të drejtat e arkëtueshme, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2024 deklarohen si vijon:

3 Të drejta të arkëtueshme

- (i) Nga aktiviteti i shfrytëzimit (Kliente etj.)
- (ii) Nga njësitë ekonomike brenda grupit
- (iii) Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse
- (iv) Të tjera
- (v) Kapital i nënshkruar i papaguar

Totali 3

Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
705,850,087	722,770,704
-	-
-	-
3,060,669	36,284,197
-	-
708,910,756	759,054,901

Në "Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit(Kliente)" jane pasqyruar faturat e papaguara per sherbimet e ndertimit qe shoqeria ka realizuar gjate ushtrimit.

Ndërsa në "Të Tjera (Debitore të tjerë)" jane pasqyruar kërkesat debitore ndaj tatim taksave.

Drejtimi mendon se të gjitha kërkesat do të arkëtohen në një periudhë afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

4. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2024. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit perhershëm. Si politike kontabel ne percaktimin e koston se inventarit eshte përdorur metoda "mesatares se ponderuar", gjeneruar nga programi "Financa 5".



Handwritten signature

4 Inventarët

- (i) Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme
- (ii) Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte
- (iii) Produkte të gatshme
- (iv) Mallra
- (v) Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)
- (vi) AAGJM të mbajtura për shitje
- (vii) Parapagime për inventar

Totali 4

Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
-	-
-	-
-	-
394,091,149	382,169,552
-	-
-	-
-	-
394,091,149	382,169,552

Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2024 është 1,041,235,086 ALL.

Shuma e inventarit të paraqitur në "Lëndët e para" përfaqëson stokun e lendeve të para dhe materialeve ndihmëse që përdoren në procesin e prodhimit dhe tregtimit të vlerësuar me koston mesatare të ponderuar. Ndërsa në "Produkte të gatshme" pasqyrohen produktet jo lende të para të përdorura për kryerjen e aktivitetit ekonomik.

Posti "Mallra për shitje" përbehet nga inventari i mallrave të marra brenda vendit, të destinuar për shitje dhe të vlerësuar me koston mesatare të marrjes.

5. Shpenzime/Të Ardhura të Shtyra

Nuk janë evidentuar shtesa në shpenzime të shtyra në fund të ushtrimit.

6. Aktivët Afatgjatë

Aktivët Afatgjatë Financiare

6 Investimet financiare afatgjatë

- (i) Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit
- (ii) Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit
- (iii) Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse
- (iv) Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse
- (v) Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjatë
- (vi) Tituj të tjerë të huadhënies

Totali 1.

Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
-	-
-	-
-	-
-	-
-	-
10,740,325	14,069,940
10,740,325	14,069,940

Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM-te)

AAM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, janë matur me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe në pasqyrën e pozicionit financiar AAM-të janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mëposhtme janë të perputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit Dhjetor 2024.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Drejtimi mendon se përgjithësisht në këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënjes në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Gjendjet e AAM-ve në fillim dhe fund të ushtrimit paraqiten:

	Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Aktivët e tjera afatgjatë materiale	Totali
	Kosto e AAM-ve më 01.01.2024	-	-	121,529,792	13,621,584	135,151,376
A	Shtesat	-	-	24,679,391	718,545	25,397,936
	Pakesimet	-	-	(26,712,462)	-	(26,712,462)
	Kosto e AAM-ve 31.12.2024	-	-	119,496,721	14,340,129	133,836,850
	Amortizimi AAM-ve 01.01.2024	-	-	90,995,092	11,552,629	102,547,721
B	Amortizimi ushtrimit	-	-	8,641,682	571,766	9,213,448
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	(22,747,367)	-	(22,747,367)
	Amortizimi i AAM-ve 31.12.2024	-	-	76,889,407	12,124,395	89,013,802
	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2024	-	-	-	-	-
C	Shtesat	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2024	-	-	-	-	-
	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2024	-	-	30,534,700	2,068,955	32,603,655
D	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2024	-	-	42,607,314	2,215,734	44,823,048

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë njëta me ato që përdoren për qëllime fiskale.

7. Detyrime Afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtera në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2024 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
1	Tilujt e Huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	-	-
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)	554,315,951	545,925,323
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup(Dividente)	-	-
7	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje	-	-
8	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet. Paga dhe shpërblime Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	902,356	881,110
9	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore Shteti-Tatim mbi fitimin Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar Tatim mbi të ardhurat nga punësimi Tatimi në burim	11,258,631 8,740,015 535,512 120,557	- 3,910,577 1,326,343 45,000
10	Të Tjera të Pagueshme	-	-
	Totali	575,873,022	552,088,353

"Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit" paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj Furnitoreve të ndryshem në fund të ushtrimit.

"Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet." paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj personelit dhe detyrimin e muajit Dhjetor 2024.

"Të Pagueshme për Detyrime Tatimore " perbehet nga Tatim mbi të ardhurat personale dhe Te tjera të pagueshme.

8. Detyrimet Afatgjata-Huate afatgjata

Detyrimet afatgjata në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2024 paraqiten:

8 Detyrime afatgjata:

- (i) Titujt e huamarrjes
- (ii) Detyrime ndaj institucioneve të kredisë
- (iii) Arkëtime në avancë për porosi
- (iv) Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit
- (v) Dëftesa të pagueshme
- (vi) Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit
- (vii) Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse
- (viii) Të tjera të pagueshme (Dividend)

Totali 8

Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
-	-
-	-
-	-
-	-
-	-
-	-
1,082,303,589	1,131,007,821
1,082,303,589	1,131,007,821

Detyrimet e mesiperme përfaqesojnë vlerën e dividendeve të destinuar për shpërndarje nëpërmjet vendimeve të asamblese së përgjithshme ende të palikuiduar ndaj ortakëve.

9. Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në bilanc, përfshin ndryshimet dhe vendimet e depozituara në QKB. Me 31.12.2024 ai është 220,000,000 ALL, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 220,000,000 ALL /kuotë.

10. Fitimi (humbja) e vitit financiar

☐ Te ardhurat

Te ardhura të realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) të biznesit paraqiten si vijon:

Te ardhurat	Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
Te ardhurat nga shitja e produkteve	-	-
Te ardhurat nga kryerja e shërbimeve	41,717,387	38,316,117
Te ardhurat nga shitja e mallrave	1,422,381,280	1,236,792,728
Te ardhura të tjera	3,945,467	1,249,454
Shuma	1,468,044,134	1,276,358,299

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Paraqitja në pasqyrat financiare të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

Handwritten signature

□ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Lloji i shpenzimit	Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
> Mallra, Lendet e para dhe shërbimet	1,041,235,086	913,697,418
> Kosto e Punes	81,727,589	81,706,013
> Amortizimi	9,213,448	7,924,531
> Furnitura, nentrajtime dhe shërbime	27,562,990	25,611,427
> Qira	5,696,653	5,605,557
> Mirembajtje dhe riparime	2,343,429	1,488,671
> Sigurime	1,087,014	1,033,989
> Udhetime e Dieta	3,541,394	3,012,234
> Telefoni, internet	1,684,711	1,699,644
> Shpenzime transporti	5,103,702	5,358,112
> Shpenzime bankare	2,051,044	2,205,962
> Tatime, taksa dhe derdhje te ngjashme	2,610,227	2,647,549
> Kosto AQ te shitura	3,965,095	170,886
> Sponsorizime, pritje, dhurata	4,682,869	4,343,745
> Gjoha dhe Demshperblime	2,095,652	1,567
> Shpenzime te tjera rrjedhese	990,759	5,001,766
Totali	1,195,591,662	1,061,509,071

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumet faturuara ose shumet e pagueshme, te perbera nga Furnitura e shërbime nga te trete, telefoni, sigurime, Tatime, taksa dhe derdhje te ngjashme, komisione bankare etj.

□ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

11. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2024 jane si vijon:

REZULTATI TATIMOR 2024	Viti raportues 31.12.2024	Viti paraardhës 31.12.2023
I Fitimi neto para tatimit	421,200,642	291,667,497
II Shpenzime te pazbriteshme (+)	(6,474,001)	(7,012,604)
Amortizime tej normave fiskale	(934,223)	-
Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	(562,839)	-
Gjoha, penalitete, demshperblime	(3,086,411)	(7,012,604)
Provizione qe nuk njihen	(334,131)	-
Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	(1,556,397)	-
Te tjera	-	-
III Pjesa e humbjes se mbartur(-)	-	-
IV Fitimi (Humbja) Tatimore(I+II-III)	427,674,643	298,680,401
Shpenzimi i tatim fitimit-15%	64,151,196	44,802,015
V FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	357,049,446	246,865,482

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

Ne tabelle janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale dhe shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyrë, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme dhe mbartjen e humbjeve. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 15%.

12. Transaksione të paleve të lidhura e shpjegime mbi palët e lidhura

Ne marrjen në konsideratë të çdo transaksioni dhe marrëdhënie të mundshme, jo thjesht formen ligjore të tyre, në 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 transaksionet dhe saldot me palët e lidhura janë si me poshte:

Levizje	2024	2023
Blerje nga:		
Blerje mallrash LABOPHARMA	13,308,716	8,698,849
Ofrimi i shërbimeve LABOPHARMA	-	-
Blerje të tjera nga LABOPHARMA	-	-
Blerje mallrash PEGASUS MED	-	29,400
Ofrimi i shërbimeve PEGASUS MED	-	-
Blerje të tjera nga PEGASUS MED	-	-
Blerje mallrash LABORATORY NETWORKS	-	-
Ofrimi i shërbimeve LABORATORY NETWORKS	-	-
Blerje të tjera nga LABORATORY NETWORKS	-	-
Blerje mallrash PEGASUS SHPK KOSOSVE	1,140,164	(223,101)
Ofrimi i shërbimeve PEGASUS SHPK KOSOSVE	-	-
Blerje të tjera nga PEGASUS SHPK KOSOSVE	-	-
Shitje kundrejt:		
LABOPHARMA	258,449,783	141,946,849
PEGASUS MED	18,861,578	14,834,700
LABORATORY NETWORKS	-	678,340
PEGASUS SHPK KOSOSVE	8,734,055	12,642,012
Te ardhura të tjera		
LABOPHARMA	-	-
PEGASUS MED	-	-
LABORATORY NETWORKS	-	-
PEGASUS SHPK KOSOSVE	-	-
Te ardhura financiare		
Te ardhura nga interesi	-	-
Te ardhura nga dividendet	-	-
Saldo të arketueshme		
Llogari të arketueshme LABOPHARMA	278,255,299	375,763,856
Llogari të tjera të arketueshme LABOPHARMA	-	-
Llogari të arketueshme PEGASUS MED	-	-
Llogari të tjera të arketueshme PEGASUS MED	-	-
Llogari të arketueshme LABORATORY NETWORKS	-	-
Llogari të tjera të arketueshme LABORATORY NETWORKS (*)	-	-
Llogari të arketueshme PEGASUS SHPK KOSOSVE	41,239,489	49,614,837
Llogari të tjera të arketueshme PEGASUS SHPK KOSOSVE	-	-
TOTALI	319,494,788	425,378,693
Saldo të pagueshme		
Llogari të pagueshme LABOPHARMA	24,418,164	12,186,697
Llogari të tjera të pagueshme LABOPHARMA	-	-
Llogari të pagueshme PEGASUS MED	-	-
Llogari të tjera të pagueshme PEGASUS MED	-	-
Llogari të pagueshme LABORATORY NETWORKS	-	-
Llogari të tjera të tjera të pagueshme LABORATORY NETWORKS	-	-
Llogari të pagueshme PEGASUS SHPK KOSOSVE	1,138,540	2,239,194
Llogari të tjera të tjera të pagueshme PEGASUS SHPK KOSOSVE	-	-
TOTALI	25,556,705	14,425,891



Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, ne 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 ekzistojne marredhenie me palet e lidhura si me poshte:

LABOPHARMA – kontroll i perbashket

PEGASUS MED – kontroll

LABORATORY NETWORKS – nen kontrollin e LABOPHARMA

PEGASUS SHPK (KOSOVE) – kontroll

13. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

14. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2024 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2, (të përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2023 janë riparaqitur sipas këtyre zërave.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i PEGASUS. sh.p.k:

Hartuesi

Estela Guma



Administratori

/ Janis Karathano

Nafize Bello
Me prokuror

Bello